



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prot. 350
28.08.2021



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE

Nr. 1513 Prot.

Tiranë më 28.08 2021

Lënda: Dërgohet Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Drejtuar: Fakulteteve/Institutit _____

Bibliotekës Shkencore

Këtu

Bashkëlidhur ju dërgojmë për njohje dhe zbatim urdhërin e ardhur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 413, datë 24.09.2021 "*Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit COVID-19 për personelin e institucioneve arsimore dhe studentet*".

Nga ana juaj të merren masat për identifikimin dhe njoftimin personelit (akademik, ndihmësakademik dhe administrativ) si dhe studentët për të depozituar Certifikatën e Vaksinimit Covid-19 nga e-albania ose kartën e vaksinimit pranë institucionit.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

REKTORI

Prof. Dr. Andrea MALIQARI



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 3951 prot.

Tiranë, më 24.09/2021

URDHËR

Nr. 413, datë 24.09.2021

**“PËR MARRJEN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E INFEKSIONIT COVID-19
PËR PERSONELIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE DHE STUDENTËT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 7, të nenit 18, të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” të ndryshuar, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, të Komitetit të ekspertëve të Imunizimit të datës 29.08.2021 si edhe në zbatim të Vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 3614 prot, datë 30.08.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019


URDHËR O J:

1. Të gjithë personat që rrezikohen dhe përbëjnë rrezik për të tjerët, për të penguar përhapjen e sëmundjeve infektive përmëshin detyrimet e përcaktuara në nenin 18, pika 7, gërma a/ii të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” të ndryshuar.
2. Personeli i institucioneve arsimore dhe studentët si një ndër kategoritë e përfshira në pikën 1, të këtij urdhëri, duhet të depozitojnë pranë qendrës së punës dhe studentët pranë zyrave të përcaktuara nga IAL-të përkatëse, Certifikatën e Vaksinimit Covid-19 nga e-albania apo kartën e vaksinimit.
3. Për punonjësit e institucioneve arsimore që nuk paraqesin Certifikatën e Vaksinimit Covid-19 apo kartën e vaksinimit, do të kërkohej paraqitja, çdo javë, e testit PCR, të kryer sipas procedurës për kryerjen e testeve për efekte administrative, për të verifikuar që nuk janë mbartës të infeksionit Sars-Cov-2, duke filluar nga data 27.09.2021.
4. Për studentët që nuk paraqesin Certifikatën e Vaksinimit Covid-19 apo kartën e vaksinimit, drejtuesit e Institucioneve të Arsimit Universitar të marrin masa për ofrimin e studimit në platforma alternative duke filluar nga 11.10.2021.
5. Institucionet arsimore të identifikojnë personelin e institucionit arsimor dhe studentët që kanë depozituar Certifikatën e Vaksinimit Covid-19 apo kartën e vaksinimit dhe të raportojnë pranë Institutit të Shëndetit Publik informacion mujor mbi identifikimin e kryer.

Adresa: Rruga e Kavajës Nr 1001, Tirana, Albania. Tel: +355 42376178/ext 72128 www.shendetesia.gov.al

6. Përfshatim nga rregullat e përcaktuara në këtë urdhër bëhet vetëm për rastet që kanë indikacion mjekësor të përcaktuar me dokument mjekësor për mosaplikimin e vaksinës.
 7. Instituti i Shëndetit Publik të marrë masat dhe të monitorojë mbulimin vaksinal të grupet e përmendura në pikën 2 të këtij Urdhri dhe të raportojë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
 8. Ngarkohet Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik të bashkëpunojnë me institucionet e arsimit të lartë, për zbatimin e këtij Urdhri.
 9. Ky urdhër i përcillet ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

MINISTRI
Ogerta Manastirliu



Adresa: Rruga e Kavajës Nr 1001, Tirana, Albania. Tel: +355 42376178/ext 72128 ee@shendetesia.gov.al